



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 30, Datë 28.02.2019

MBI

**PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “A.E DISTRIBUTION” SH.P.K. PËR
HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË FURNIZIMIT ME ENERGJI
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 5 gërma “dh”; nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE, nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- ERE me Vendimin e Bordit nr. 83, datë 09.06.2016, ka licencuar shoqërinë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE nr. 157 Prot, datë 14.02.2019, ka kërkuar me vullnetin e saj të plotë, heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
- Kërkesa e shoqërisë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k. për heqjen e licencës së furnizimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42 pika 1, gërma “dh”, “Heqja e një licence”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017.
- Subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit ndaj ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “A.E DISTRIBUTION” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike me nr. 345 Seria F16, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 09.06.2016.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë kërkuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
ERJOLA SADUSHI**

**KRYETARI
Petrit AHMETI**